

PËRMBLEDHJE E DËGJESËS PUBLIKE

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale

Qarku Lezhë | 22 Prill 2026

1. Konteksti dhe kuadri i dëgjësës

Dëgjesa publike e Lezhës u zhvillua më 22 prill 2026, si pjesë e konsultimeve parlamentare për reformën administrative-territoriale. Diskutimi u përqendrua te organizimi territorial, qeverisja vendore, funksionet, kompetencat, shërbimet dhe financat vendore, me fokus praktik te përvoja e qytetarëve dhe të zgjedhurve vendorë në bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë.

2. Qeverisja vendore dhe përfaqësimi

Gjetje kryesore

Afërsia e pushtetit vendor me qytetarin mbetet një nga kriteret kryesore për vlerësimin e reformës dhe të funksionimit të bashkive.

Në dëgjese u shprehën qëndrime të ndryshme mbi madhësinë optimale të bashkive: një pjesë e ndërhyrjeve theksuan nevojën për bashki më të vogla dhe më përfaqësuese, ndërsa të tjera vlerësuan se bashkitë më të mëdha krijojnë më shumë kapacitete administrative, teknike dhe financiare.

Qarku i Lezhës u paraqit si territor me profile të ndryshme zhvillimi, ku bashkëveprojnë zona urbane, bregdetare, bujqësore, malore dhe industriale, çka kërkon model qeverisjeje që të ruajë veçoritë lokale dhe të mundësojë koordinim më të mirë ndërbashkiak.

Njësitë administrative dhe ish-komunat perceptohen nga një pjesë e pjesëmarrësve si hallka ku qytetari kërkon kontaktin e parë me bashkinë, por roli i tyre aktual përfaqësues dhe vendimmarrës mbetet i kufizuar.

Gjetje dytësore

Identiteti lokal i Kurbin, Mirditës, Lezhës dhe zonave përbërëse u përmend si faktor që duhet marrë në konsideratë në çdo diskutim për organizimin territorial.

Disa ndërhyrje kërkuar të shmangët reduktimi i debatit vetëm te harta territoriale, duke e lidhur reformën me decentralizimin, autonominë, kompetencat dhe cilësinë reale të shërbimeve.

U evidentua nevoja që niveli rajonal/qarku të ketë rol më të qartë në zhvillim, koordinim ndërbashkiak dhe përgatitje për fondet e Bashkimit European.

Në disa ndërhyrje u theksua se përfaqësimi i zonave rurale dhe periferike në vendimmarrje duhet të forcohet, pavarësisht nëse harta territoriale ndryshon apo jo.

3. Mbështetja ligjore dhe burimet

Gjetje kryesore

Kuadri ligjor përcakton funksionet vendore, por zbatimi praktik i tyre pengohet kur kompetencat, burimet financiare dhe burimet njerëzore nuk përputhen plotësisht me përgjegjësitë që i kërkojnë bashkisë.

U evidentua nevoja për ndarje më të qartë të përgjegjësiave mes pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe strukturave rajonale, në mënyrë që qytetari të dijë ku drejtohet për çdo shërbim.

Disa pjesëmarrës ngritën shqetësimin se reforma të tjera sektoriale dhe centralizimi i disa shërbimeve kanë ndikuar në aksesin vendor në drejtësi, arsim, kadastër, bujqësi, shëndetësi dhe shërbime të tjera publike.

Bashkitë kanë nevojë për kapacitete teknike më të qëndrueshme, përfshirë specialistë të planifikimit, inxhinierë, topografë, juristë dhe staf të aftë për projektim, prokurim, menaxhim dhe zbatim të investimeve.

Gjetje dytësore

Forcimi i administratorëve të njësive administrative u përmend si mundësi për ta lidhur më mirë bashkinë me fshatrat dhe zonat periferike.

Në disa raste u kërkua që kompetencat ekskluzive, të përbashkëta dhe të deleguara të jenë më të kuptueshme në praktikë dhe të shoqërohen me burimet përkatëse.

U vu në dukje se bashkitë më të vogla mund të kenë vështirësi për të siguruar të gjitha kapacitetet profesionale të nevojshme, ndërsa bashkitë më të mëdha mund të rrezikojnë distancim nga komunitetet nëse njësitë administrative nuk funksionojnë mirë.

Nevoja për analizë të pavarur dhe të bazuar në tregues mbi rezultatet e reformës së mëparshme u artikulua si kusht për korrigjime të qëndrueshme.

4. Funkcionet, kompetencat dhe shërbimet

Gjetje kryesore

Cilësia dhe afërsia e shërbimeve publike mbeten çështjet më të ndjeshme për qytetarët, veçanërisht në zonat rurale, periferike dhe malore.

U evidentuan përvoja të ndryshme mbi performancën e shërbimeve pas reformës: disa ndërhyrje raportuan përmirësime në ujësjellës, infrastrukturë, shkolla dhe kanalizime, ndërsa të tjera ngritën shqetësime për largim shërbimesh, dobësim të njësive administrative dhe mungesë investimesh në ish-komuna.

Rrugët rurale, mirëmbajtja e tyre, vaditja, kullimi, furnizimi me ujë, kanalizimet, shërbimet sociale, arsimi dhe shëndetësia u përmendën si fusha ku qytetarët presin përmirësim të prekshëm.

Funkcionet që lidhen me bujqësinë, kullimin, vaditjen, mbrojtjen nga përmbytjet dhe administrimin e infrastrukturës bujqësore kërkojnë koordinim më të mirë dhe përgjegjësi më të qarta në nivel vendor dhe rajonal.

Gjetje dytësore

Në Kurbin u ngritën si çështje specifike shërbimet në Mamurras, sistemi i kullimit, përmbytjet, gjendja e rrugëve dhe lidhja mes njësive administrative dhe qendrës së bashkisë.

Në Lezhë u përmendën investime në ujësjellës, kanale vaditëse dhe shpërndarje investimesh në zona rurale, por edhe nevoja për më shumë kapacitete dhe shërbime të specializuara, si gjendja civile.

Në Mirditë u theksuan distancat, mirëmbajtja e rrugëve, vështirësitë e zonave malore dhe nevoja që shërbimet të mos maten vetëm me numër banorësh, por edhe me territor, akses dhe kosto reale.

Ujësjellësi u paraqit me rezultate të ndryshme: në disa zona u raportuan përmirësime të furnizimit, ndërsa u kërkua që bashkitë të kenë rol operacional dhe koordinues më të fortë për cilësinë e shërbimit.

Bashkëpunimi ndërbashkiak dhe roli rajonal u përmendën si zgjidhje për shërbime që tejkalojnë kapacitetin e një bashkie të vetme, veçanërisht për projekte infrastrukturore dhe zhvillimore.

5. Parimet e financimit të njësive të qeverisjes vendore

Gjetje kryesore

Autonomia financiare u identifikua si kusht për ushtrimin real të kompetencave dhe për përmirësimin e shërbimeve në të gjithë territorin e bashkive.

Formula aktuale e financimit u konsiderua nga disa pjesëmarrës si e pamjaftueshme për të reflektuar koston reale të shërbimit në bashki me territor të gjerë, relief të vështirë, popullsi të shpërndarë, zona rurale, bregdetare dhe malore.

U theksua se bashkitë duhet të kenë burime më të sigurta dhe fleksibilitet më të madh për përdorimin e fondeve, në mënyrë që të përgjigjen më shpejt ndaj prioriteteve lokale.

Të ardhurat vendore, transfertat nga buxheti i shtetit dhe aftësia e bashkive për të gjeneruar të ardhura u diskutuan si elemente që duhet të lidhen më qartë me përgjegjësitë dhe cilësinë e shërbimit.

Gjetje dytësore

Në disa ndërhyrje u kërkua rritje e peshës së financimit për pushtetin vendor dhe rishikim i formulës së transfertës në raport me nevojat reale të territorit.

U ngrit shqetësimi se bashkitë që kanë më pak bazë tatimore ose territor më të vështirë nuk mund të krahasohen vetëm mbi kriterin e popullsisë.

U vlerësua se bashkitë më të mëdha mund të kenë më shumë mundësi për ekonomi shkalle, ulje detyrimesh të trashëguara dhe investime më të mëdha, por kjo duhet të shoqërohet me shpërndarje të drejtë brenda territorit.

Taksat dhe tarifat vendore duhet të lidhen më qartë me shërbimet që qytetarët marrin, në mënyrë që kontributi vendor të perceptohet si pjesë e llogaridhënies së bashkisë.

6. Transparenca dhe llogaridhënia

Gjetje kryesore

Qytetarët kanë nevojë për përgjegjësi të qartë institucionale për çdo shërbim: kush e financon, kush e zbaton, kush e mbikëqyr dhe kush përgjigjet kur shërbimi mungon.

Llogaridhënia dobësohet kur shërbimet ndahen midis disa strukturave dhe kur njësitë administrative nuk kanë kompetenca ose burime të mjaftueshme për të ndjekur problemet e komunitetit.

U evidentua nevoja që prioritetet e investimeve midis qytetit, fshatit, zonave bregdetare, malore dhe bujqësore të shpjegohen më qartë dhe të bazohen në tregues të matshëm.

Debati publik duhet të mbetet i fokusuar te interesat e qytetarëve dhe te funksionimi real i pushtetit vendor, duke shmangur reduktimin e reformës në llogari politike ose vetëm në ndryshim kufijsh.

Gjetje dytësore

Përfaqësimi në këshillat bashkiakë, roli i administratorëve dhe pjesëmarrja e qytetarëve u përmendën si hallka të rëndësishme për llogaridhënien reale në nivel komuniteti.

U kërkua më shumë informacion i aksesueshëm mbi financat vendore, borxhet e trashëguara, investimet, shpërndarjen territoriale të buxhetit dhe rezultatet e shërbimeve.

Monitorimi i performancës së bashkive duhet të mbështetet në tregues të krahasueshëm për të ardhurat, shpenzimet, investimet, shërbimet, borxhet dhe aksesin territorial.

Procesi i konsultimit u vlerësua si i rëndësishëm për të dëgjuar zëra të ndryshëm dhe për të ndërtuar një reformë që reflekton nevojat konkrete të komuniteteve.

Shënim metodologjik

Ky dokument është hartuar mbi bazën e transskriptit të plotë të dëgjesës publike dhe përfaqëson të gjitha zërat e shprehura, duke ruajtur balancimin ndërmjet qasjeve divergjente. Ai nuk shpreh qëndrimin zyrtar të Komisionit, por dokumenton diversitetin e opinioneve të shprehura gjatë sesionit. Dëgjesa u moderua nga Valbona Karakaci, Këshilltare Strategjike pranë projektit Bashkitë Forta, dhe u regjistrua në tërësi. Transkripti i plotë dhe ky raport do të bëhen publike në faqen e reformës.